

**AKT THEMELEMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ROBINSON CRUSOE” SHPK.**

NENI 1

Ne Tirane, sot me daten 28.2.2023, ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ‘Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare’ dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, themelohet shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me mertimin **“Robinson Crusoe” SHPK.**

NENI 2

Ortaket themelues te shoqerise jane :

1. Klodjan Islami- me adresë, rruga Gjike Kuqali, Pall. N. 2, shk. Nr.5, ap. Nr. 21, Tirane, pjesa në pronësi 50,000.00 leke.
2. Alderon Islami- me adresë, rruga Ibrahim Dervishi, ndertesa nr. 15, njesia administrative nr. 5, Tirane, pjesa në pronësi 50,000.00 leke.

NENI 3
Emërtimi

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **“Robinson Crusoe” sh.p.k.**

Emërtimi i shkurtuar i shoqërisë është **“Robinson Crusoe” sh.p.k.**

NENI 4
Selia

Seli e Shoqerise **“Robinson Crusoe” SH.P.K** do te jetë ne Tirane, ne adresen: Rruga Bako Dervishaj, Pallati Vjero, kati i dyte,Tirane.

Pervec ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendoror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit. Selia e Shoqerise mund te ndryshoj me vendim te Asamblese se Përgjithëshme.

NENI 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vundos Asambleja e Pergjitheshme.

Two handwritten signatures in blue ink are placed side-by-side. The signature on the left appears to be "Klodian Islami" and the one on the right appears to be "Alderon Islami".

NENI 6
Objekti i Veprimitarisë

Objekti i Veprimitarisë është:

Aktivitet ne agjenci te udhetimeve turistike dhe operatorit turistik, e agentit portual, agentit doganor, transport turistik te udhetareve, guide turistike dhe zhvillimin e aktivitetit te konsulences menaxheriale per sa i perket turizmit ne nivel internacional si dhe cdo aktivitet tjeter qe lidhet me sa me siper; Transportimin e mallrave, njerezve me mjete tokesore, detare, ajrore si me mjete te veta ose me mjete te treteve; Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, financiare dhe kreditore si dhe te bleje, shese apo te marre dhe te jape me qira pasuri; Menaxhimin e lokaleve, restoranteve, diskotekave, kinemave dhe aktiviteteve publike; Organizimin dhe menaxhimin e fshatrave turistike, campingjeve, hoteleve, hosteleve, apartamenteve. Bed & Breakfast, dhe iniciativa ne sektorin turistik dhe te kohes se lire; Organizime eventesh, kongresesh, seminaresh, trajnimesh dhe manifestime te gjitha llojeve. Menaxhimin e sherbimeve te lidhura me argetimin dhe organizimin e ketyre te fundit. Blerje/ shitje dhe dhenien me qira, me ose pa shofer per llogari te personave te trete, te automjeteve, motorcikletave, ciklomotorave, bicikletave etj; Kembim valute; Veprimitari e Agentit Komisioner; Sherbirne te lidhura me asistencen teknike, menaxhuese ose te strategjive te linjave, drejtuese, tregtare dhe administrative.

Sherbime Keshillimi, Menaxhimit te Projekteve, te Edukimit dhe trajnimit ndaj te treteve ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit, burimeve njerezore, ekonomike, financiare, te biznesit dhe investimeve, te marketingut, te promovimit, studimeve te tregut, ne fushen e kerkimit dhe botimit shkencor. Aktivitete shtese krahas atyre themeltare ne perputhje me objektin e shoqerise.

KAPITALI
NENI 7
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 100 000 Leke. Ky kapital ndahet në 2 (dy) kuota secila me vlere prej 50 000 leke secila, te nenshkuara nga ortakët. Ky eshte kapitali efektiv qe nga regjistrimi i shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqërisë ndahet në kuota të zotëruara prej ortakëve, si më poshtë.

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Klodjan Islami	% 50	1	50 000 leke
Alderon Islami	% 50	1	50 000 leke

Kapitali themeltar depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

NENI 8

Administrator i shoqerise do te jetë Z. Alderon Islami, i biri i Shpresa dhe Pajtim, lindur në Vlorë më 4.9.1977 kartë identiteti H70904043V dhe banues në: Rruga Ibrahim Dervishi, ndertesa nr. 15, njesia administrative nr. 5, Tirane.

NENI 9


Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

NENI 10 *Dispozita e fundit*


Ky akt themelimi është perpiluar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Klodjan ISLAMI

Klodjan Islami

Alderon ISLAMI

Alderon Islami